



AGJENCI ADMINISTRIMI KOLEKTIV

Drejtuar:

Znj.Eni Vasili
Drejtores e Radio Televizionit Publik Shqiptar

Për Dijeni

Z.Blendi Gonxhe
Minister i Kulturës, Turizmit dhe Sporteve

Znj.Borana Ajazi
Drejtores e Drejtorisë Për të Drejtat e Autorit MTKS

Znj.Armela Krasniqi
Kryetare e Autoritetit të Mediave Audiovizive

Z.Gentian Sala
Kryetar i Autoritetit të Komunikimit Elektronik dhe Postar

Z.Eljan Tanini
Drejtor i Arkivit Qëndror, Shtetëror të Filmit

CC. Mr Silvio Gonzato, Head of the EU Delegation in Tirana

CC. Mrs. Emmanuelle du Chalard, Head of the Copyright unit, European Commission

Tiranë më, 12.03.2026

E Nderuar Znj.Vasili.

Agjencia F.A.A.D është licencuar nga Ministria e Turizmit, Kulturës dhe Sportit (MTKS) në dhjetor 2024, për të ushtruar veprimtari në fushën e menaxhimit kolektiv dhe mbrojtjes së të drejtave të autorëve të veprave audiovizuale dhe të prodhuesve të veprave audiovizuale.

Kjo licencë nënkupton se agjencia ka të drejtë të:

Përfaqësojë autorët dhe producentët audiovizualë në mbrojtjen e të drejtave të tyre.

Administrojë dhe mbledhë të ardhurat që burojnë nga përdorimi i veprave audiovizuale (transmetim, ritransmetim, platforma digjitale, etj.) të ardhurat tek mbajtësit e të drejtave sipas rregullave të menaxhimit kolektiv.

Monitorojë përdorimin e veprave audiovizuale dhe të ndërmarrë veprime administrative ose ligjore në rast shkeljesh të së drejtës së autorit.



AGJENCI ADMINISTRIMI KOLEKTIV

Licencimi nga MTKS e vendos F.A.A.D si një organizatë të menaxhimit kolektiv të të drejtave të autorit, që operon në përputhje me ligjin shqiptar për të drejtën e autorit për kategorinë e mbajtësve të të drejtave që përcaktohen në nenin 97 të Ligjit 35/2016, dhe për të drejtat që përcaktohen nga neni 25 deri në 37 të ligjit, por pa u kufizuar vetëm në këto kategori dhe të drejta.

Nga monitorimi i OSHMA-së tuaj kemi konstatuar nisjen së fundmi të një projekti për publikimin në platformën YouTube / Google të materialeve audiovizuale të ruajtura ndër vite në arkivin e institucionit tuaj.

Gjithashtu, në një nga programet tuaja të mëngjesit është deklaruar publikisht nga një përfaqësues i RTSH se: *“materialet do të publikohen falas në YouTube, në mënyrë që të mund të shihen nga publiku në të gjithë botën.”*

Kjo deklaratë publike dhe aktiviteti i nisur për publikimin e këtyre materialeve pa autorizimin përkatës të autorëve ka ngritur shqetësim serioz dhe njëkohësisht na detyron të ngremë alarmin për shkelje të legjislacionit në fuqi që rregullon mardhëniet për të drejtat e autorit dhe të drejtat e lidhura me to, konkretisht:

Ligji Nr. 35/2016 “Për të Drejtën e Autorit dhe të Drejtat e Lidhura me të”

Ligji Nr. 97/2013 “Për Mediat Audiovizive në Republikën e Shqipërisë”

Ligji Nr. 54/2024 dhe Ligji Nr. 46/2015, si dhe aktet nënligjore përkatëse në zbatim të tyre Direktiva (BE) 2019/790 mbi të drejtën e autorit në tregun unik digjital

Neni 58 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, që garanton mbrojtjen e pronësisë intelektuale.

Nga verifikimi i kanalit tuaj në YouTube rezulton se ky kanal është krijuar në vitin 2021 dhe aktualisht gjeneron të ardhura nga shikimet dhe reklamat. Megjithatë, nuk rezulton që këto të ardhura të jenë publike apo transparente, ndërkohë që, në dijeninë tonë, autorët dhe mbajtësit e të drejtave të veprave të publikuara nuk kanë përfituar asnjë shpërblim nga përdorimi i këtyre veprave.

Në cilësinë e një institucioni publik, krijimi dhe administrimi i të ardhurave nga shfrytëzimi i veprave audiovizuale duhet të kryhet në përputhje të plotë me legjislacionin në fuqi dhe me transparencë të plotë ndaj mbajtësve të të drejtave.

Gjithashtu, vlerësojmë se aktualisht institucioni juaj nuk gëzon të drejtë autoriale për publikimin dhe shfrytëzimin digjital të një pjese të konsiderueshme të materialeve arkivore, veçanërisht për veprat e realizuara para vitit 2000, pasi:

Në momentin e realizimit të tyre nuk ekzistonte kjo formë shfrytëzimi teknologjik;



AGJENCI ADMINISTRIMI KOLEKTIV

Në përputhje me Ligjin Nr. 35/2016, neni 69, pika 1, 5 dhe 6, të drejtat për përdorimin dhe shfrytëzimin e këtyre veprave nuk mund të prezumohen në favor të institucionit tuaj pa autorizimin përkatës të autorëve ose të mbajtësve të të drejtave.

Për sa më sipër, kërkojmë nga ana juaj ndërprerjen e menjëhershme të këtij projekti dhe pezullimin e publikimit të materialeve audiovizuale të cilat nuk gëzojnë autorizimin e autorëve në platforma digjitale brenda një afati prej 7 (shtatë) ditësh nga marrja e kësaj shkrese.

Agjencia F.A.A.D, së bashku me autorët dhe mbajtësit e të drejtave, do të jetë e detyruar t'i drejtohet organeve kompetente dhe Gjykatës Penale, si dhe të ndërmarrë të gjitha veprimet ligjore të parashikuara nga legjislacioni në fuqi për mbrojtjen e të drejtave të autorit dhe interesave të ligjshme të përfaqësuar prej saj, në rast se Institucioni që ju përfaqësoni nuk do të ndërgjegjësohet për Respektimin e këtyre të drejtave.

FILMI AUDIOVIZUAL,
ARTISTEVE E SHKRUAR
F.A.A.D.